

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6246
E hënë, 22 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

Pandemia, 54 për qind
e shqiptarëve rritën
blerjet në internet **FAQE 9**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ENDE NUK DIHET KOHA SE KUR MUND TË SHPALLET REZULTATI PËRFUNDIMTAR I
ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË MBAJTURA MË 14 SHKURT **FAQE 4**

OPINION

ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT,
TERAPIA MË E DUHUR
PËR T'I DETEKTOUAR
"SËMUNDJET" E SHITIT
TË KOSOVËS **F. 11**

Nga Mehmet
PRISHTINA



AKTUALE



KLINAKU: LUFTA JONË
KA QENË, ËSHTË DHE
DO TË MBETET E SHENJTË **F. 5**

SHËNOHET 32-VJETORI
I GREVËS SË MINATORËVE **F. 6**

SITUATA E SIGURISË NË
SUHAREKË, STABILE **F. 6**

EKONOMI



BUXHET I KUFIZUAR PËR
ZOTIMET E VETËVENDOSJES **F. 8**

INDEKSI I ÇMIMEVE TË
PRODHIMEVE BIMORE SHËNOI
RRITJE PËR 4.4 PËR QIND **F. 8**

SPORT

BALLKANI MERR KRYESIMIN
NË ELITË, LLAPI IA
"TERRON" EDHE GJILANIT **F. 12**

REZULTATI PËRFUNDIMTAR I ZGJEDHJEVE VARET NGA PUNA QË BËHET NË QNR



Shpallja e rezultatit përfundimtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për zgjedhjet e 14 shkurtit varet nga disa procese në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Ky rezultat do të

shpallet vetëm pas skanimit të listës përfundimtare të votuesve, hyrjes në sistem të të dhënave nga formularët për subjektet politike dhe kandidatët, vlerësimit të pakove me fletëvotime nga jashtë vendit, pas

numërimit të votave me kusht, votave të personave me nevoja të veçanta, si dhe votave nga jashtë vendit. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë se tashmë disa nga këto procese janë drejt përfundimit

GJATË 24 ORËVE TË FUNDIT JANË KONFIRMUAR EDHE
398 RASTE TË REJA ME COVID-19 NË KOSOVË

PAS ZGJEDHJEVE, RRIETET NUMRI I TË INFEKTUARVE ME COVID NË KOSOVË **FAQE 3**

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka theksuar se duke pasur parasysh vlerësimin dinamik dhe në kohë reale të situatës epidemiologjike me Covid-19, shifrat e fundit paraqesin numrin më të madh të rasteve pozitive këtë vit. "Numri i rasteve pozitive dhe vdekjeve nga Covid-19 vazhdon të jetë i lartë dhe shqetësues si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave", thuhet në reagimin e këtij instituti



KOSOVA, PA SOVRANITET AJROR **FAQE 5**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni viziton senatorin Bob Dole pas diagnostikimit me kancer

WASHINGTON, 21 SHKURT - Presidenti amerikan Joe Biden ka vizituar senatorin Bob Dole. Lajmin e ka konfirmuar Shtëpia e Bardhë, pasi përfaqësuesi nga Kansas, i pensionuar tashmë, ka njoftuar se është diagnostikuar me kancer në mushkëri.


Në njoftimin e Shtëpisë së Bardhë është thënë se të dy politikanët kanë shërbyer bashkë në Senat dhe Dole "është mik i afërt" i presidentit Biden.

Dole, i nominuar për president nga republikanët më 1996, ka qenë një prej republikanëve që kanë thënë zëshëm pas zgjedhjeve të 3 nëntorit të vitit 2020, se Biden ka fituar.

"Zgjedhjet kanë mbaruar dhe (Joe) Biden do të jetë president më 20 janar. Unë e di që presidenti nuk e ka pranuar humbjen dhe mund të mos e pranojë kurrë, mirëpo ai nuk do të jetë në Shtëpinë e Bardhë më 21 janar", ka thënë Dole në dhjetor të vitit të kaluar, duke i referuar ish-presidentit amerikan Donald Trump.

Dole, 97-vjeçar, ka bërë me dije lajmin për kancer më 18 shkurt. "Së fundmi, janë diagnostikuar me kancer në mushkëri, në fazën e katërt. Trajnimi im i parë do të nisë të hënën", ka thënë ai përmes një postimi në rrjetin social "Twitter". "Teksa kam disa pengesa përpara, unë e di se iu

bashkohem miliona amerikanëve që po përballen me sfidat e tyre shëndetësore". Dole ka shërbyer për 27 vjet si senator amerikan nga Kansas. Në janar të vitit 2018, ai është shpërblyer me Medalje të Artë nga Kongresi, njëherësh çmimi më i lartë civil që ndan ky institucion. Dole ka udhëhequr një delegacion të Shteteve të Bashkuara në Kosovë në vitin 1990. Në muajin gusht të vitit të kaluar, busti i tij është vendosur në Prishtinë. Përmes një video-mesazhi, senatori Dole ka shprehur mirënjohje për inaugurimin e bustit. "Më vjen keq që nuk mund të jem me ju në inaugurimin e bustit, më kujton kohën e para 30



vjetëve. Tridhjetë vjet kemi vazhdoni të punoni për t'u punuar për të krijuar një shtet bërë edhe më të fortë", ka thënë Dole.

Opozita maqedonase mbledh nënshkrime kundër regjistrimit të popullsisë

SHKUP, 21 SHKURT - Partia VMRO-DPMNE ka nisur mbledhjen e nënshkrimeve për shtyrjen e regjistrimit të popullsisë në Maqedoninë e Veriut, të paraparë për muajin prill. Opozita maqedonase pretendon se partitë në pushtet kanë kurdisur rezultatet e regjistrimit sa i përket përqindjes së shqiptarëve në shtet dhe se me një veprim të tillë, sipas saj, nuk do të ketë operacion statistikor, por politik. "Regjistrimi është një operacion statistikor, dhe si i tillë duhet të bazohet në një metodologji dhe proces që do



të tregojë rezultate reale, dhe jo false, të bazuar në marrëveshje koalicioni", thuhet në një komunikatë të

VMRO-së, e cila pretendon se vetëm të shtunën janë grumbulluar mbi 25,000 nënshkrime të qytetarëve.

Kryetari i kësaj partie, Hristijan Mickoski ka akuzuar qeverinë për rrënimin e shtetit dhe varfërimin e qytetarëve.

Sipas ligjeve në fuqi, opozita duhet të mbledhë mbi 30 000 nënshkrime për të rikthyer debatin për Ligjin e regjistrimit të popullsisë, por kjo nuk nënkupton me automatizëm dhe shtyrjen e procesit, pasi shumica parlamentare sërish mund të votojë të njëjtin ligj, që i jep formën e prerë regjistrimit të popullsisë.

Lidhja Social-Demokrate e kryeministrit Zoran Zaev, ka

thënë se asnjë nismë e opozitës nuk do të mund të shtyjë regjistrimin e popullsisë.

Maqedonia e Veriut regjistrimin e fundit e ka mbajtur në vitin 2002.

Në vitin 2012 kishte një përpjekje për regjistrimin e popullsisë, por ai ishte ndërprerë disa ditë pasi kishte nisur për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me regjistrimin e diasporës shqiptare.

Sipas regjistrimit të fundit, Maqedonia e Veriut ka rreth 2 milionë banorë, prej tyre 25.17 për qind janë shqiptarë.

Izraeli lehtëson masat e kufizimit pas suksesit të vaksinës

Jerusalem, 21 shkurt - Vaksina e kompanive Pfizer/BioNTech është gati 99 për qind efektive për parandalimin e sëmundjes serioze apo vdekjes si pasojë e sëmundjes Covid-19, ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë në Izrael, teksa ka ofruar disa të dhëna pas vaksinimit të një pjese të popullsisë. Izraeli është duke udhëhequr

në botë, në garën për vaksinim pasi deri tani një dozë të vaksinës së Pfizer/BioNTech, ua ka dhënë gati gjysmës së popullsisë prej 9 milionë banorëve. Rreth 2.9 milionë banorë izraelitë kanë marrë të dyja dozat e vaksinave. Ministria e Shëndetësisë ka thënë se të dhënat kanë treguar se vaksina është 98.9 për qind



efektive në parandalim të vdekjes dhe 99.2 për qind efektive kundër sëmundjes serioze, në mesin e atyre që kanë marrë të dyja dozat. Izraeli po synon të gjithë qytetarët e vet të moshës mbi 16-vjeçare deri në fund të muajit mars. Më 21 shkurt, dyqanet, qendrat tregtare, palestrat, disa shkolla të mesme dhe shërbime tjera

publike, kanë nisur punën sërish. Këto zhvillime kanë ndodhur pasi kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu ka publikuar më 20 shkurt planet që parashohin se njerëzit, të cilët janë vaksinuar kundër koronavirusit, do të mund të marrin pjesë në ngjarje kulturore, të udhëtojnë jashtë vendit dhe të vizitojnë palestra dhe restorante.

Shpallet gjendje e katastrofës në Teksas

Energjia elektrike po kthehet gradualisht në këtë vend dhe temperaturat po rriten, mirëpo rreth 13 milionë banorë vazhdojnë të kenë vështirësi për t'u qasur në ujë të pastër.

Biden ka thënë se do të vizitojë Teksasin nëse prezenca e tij nuk është barrë, ndërkohë që po bëhen përpjekje për ndihmë. Në gjithë Shtetet e Bashkuara është raportuar për

gati 60 persona të vdekur si pasojë e motit të ftohtë. Shumë shtete tjera jugore janë goditur po ashtu nga bora dhe stuhia e akullt këtë javë, çka ka rezultuar me mungesa të ujit.

Përgjatë jugut të Shteteve të Bashkuara, rajon që nuk është mësuar me temperatura kaq të ulëta dhe ku rezervuarët e ujit janë ngrirë, banorët kanë shkruar borën për të fituar ujë.



Gjatë 24 orëve të fundit janë konfirmuar edhe 398 raste të reja me Covid-19 në Kosovë

Pas zgjedhjeve, rritet numri i të infektuarve me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka theksuar se duke pasur parasysh vlerësimin dinamik dhe në kohë reale të situatës epidemiologjike me Covid-19, shifrat e fundit paraqesin numrin më të madh të rasteve pozitive këtë vit. “Numri i rasteve pozitive dhe i të vdekurve nga Covid-19 vazhdon të jetë i lartë dhe brengosës si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave”, thuhet në reagimin e këtij instituti

numri i rasteve aktive është 6 639.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 141 raste, Pejë 37 raste, Ferizaj 34 raste, Gjiilan 24 raste, Prizren 23 raste, Mitrovicë 20 raste, Gjakovë 19 raste, Fushë-Kosovë 16 raste, Lipjan 10 raste, Podujevë 10 raste, Vushtrri 10 raste, Klinë 9 raste, Istog 8 raste, Obiliq 8 raste, Skenderaj 6 raste, Drenas 4 raste, Kaçanik 4 raste, Malishevë 3 raste, Rahovec 3 raste, Viti 3 raste, Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Dragash, Mamushë dhe Suharekë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka theksuar se duke pasur parasysh vlerësimin dinamik

dhe në kohë reale të situatës epidemiologjike me Covid-19, shifrat e fundit paraqesin numrin më të madh të rasteve pozitive këtë vit. “Numri i rasteve pozitive dhe vdekjeve nga Covid-19 vazhdon të jetë i lartë dhe brengosës si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave. Mjekët të stërngarkuar në spitale po luftojnë kundër këtij virusi tinëzar e shkatërrimtar me tërë fuqinë e tyre profesionale e njerëzore”, ka njoftuar IKShPK-ja.

Ky institut ka përsëritur thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19.

IKShPK-ja ka rekomanduar që të qëndrohet në shtëpi dhe dalja të jetë vetëm për nevoja të domosdoshme. “Ndalimi rigoroz i takimeve me njerëz me të cilët nuk jetoni në bashkësi, pos për qëllime specifike; Ndalimi rigoroz i tubimeve; Respektimi rigoroz i masave kufizuese në aktivitetet publike; dhe kufizimi i punës për veprimtaritë joesenciale dhe vendngjarjet duke reduktuar edhe kohën e punës gjatë ditës”, është thënë në apelin e IKShPK-së.

IKShPK-ja ka vlerësuar se këto masa mund ta ndërpresin rritjen e numrit të rasteve, ta parandalojnë mbingarkesën e hospitalizimeve dhe ta parandalojnë rritjen e numrit të vdekjeve. “IKShPK-ja apelon të të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat publike dhe private, për respektimin dhe ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e infeksionit Covid-19, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, dhe vendimet në fuqi mbi masat dhe obligimet e institucioneve për zbatimin e masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19”, është thënë ndër të tjera në apelin e IKShPK-së.

EPOKA ERE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2

996 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 398 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve është raportuar një rast i vdekjes (39 vjeç) si pasojë e këtij virusi. Rasti është

nga Komuna e Drenasit.

Numri total i rasteve pozitive është 66 380 raste nga 285 900 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 572 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 228 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 58 169 raste, kurse



Nis vaksinimi i të moshuarve mbi 80 vjeç në Shqipëri

TIRANË, 21 SHKURT - Të dielën në Shqipëri ka nisur vaksinimi anti-Covid për të moshuarit mbi 80 vjeç. Kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, kanë ndjekur nga afër vaksinimin anti-Covid për personat mbi 80 vjeç në stadiumin “Air Albania”, i cili ka filluar me personalitetet e njohura dhe është pasuar me

të moshuar të tjerë të së njëjtës kategori. “Janë 80 të moshuar mbi 80 dhe 90 vjeç që vaksinohen sot në ‘Arenën Kombëtare’. Janë edhe personalitete, gjithashtu edhe të moshuar të tjerë të zgjedhur nga mjekët të familjes”, ka thënë Manastirliu.

Në stadiumin “Arena Kombëtare” u vaksinuan Margarita Xhepa, Tinka Kurti, Aleksandër Meksi, Alfred

Moisiu, Dhimitër Anagnosti, Pirro Milkani, Fedhon Meksi, Besim Elezi, Alfred Serreqi, Sherif Meidani, Pëllumb Karagozi etj. si dhe të moshuar të moshës 90-vjeçare që u organizuan nga mjekët e familjes.

Edi Rama ka takuar disa prej tyre dhe ndër ta ishte edhe ish-presidenti Alfred Moisiu, i cili po merrte dozën e parë të vaksinës.





ENDE NUK DIHET KOHA SE KUR MUND TË SHPALLET REZULTATI PËRFUNDIMTAR I ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË MBAJTURA MË 14 SHKURT

Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve varet nga puna që bëhet në QNR

Shpallja e rezultatit përfundimtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për zgjedhjet e 14 shkurtit varet nga disa procese në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Ky rezultat do të shpallet vetëm pas skanimit të listës përfundimtare të votuesve, hyrjes në sistem të të dhënave nga formularët për subjektet politike dhe kandidatët, vlerësimi i pakove me fletëvotime nga jashtë vendit, numërimi i votave me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta, si dhe votat nga jashtë vendit. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë se tashmë disa nga këto procese janë drejt përfundimit

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 SHKURT - Ende nuk dihet se kur mund të bëhet shpallja e rezultatit përfundimtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit, për faktin se shpallja e këtij rezultati varet nga puna që po

bëhet aktualisht në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka folur për "Epokën e re" për proceset nga të cilat varet publikimi i rezultatit përfundimtar të këtyre zgjedhjeve. "Nuk ka një afat ligjor se kur duhet të bëhet shpallja dhe certifikimi i rezultateve përfundimtare. Shpallja e rezultateve

përfundimtare të zgjedhjeve bëhet i mundur pasi të kryhen disa procese në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, siç janë: skanimi i listës përfundimtare të votuesve, futja në sistem e të dhënave nga formularët për subjektet dhe kandidatët, vlerësimi i pakove me fletëvotime nga jashtë vendit, numërimi i votave me kusht, votat e

personave me nevoja të veçanta dhe votat nga jashtë vendit, si dhe pasi të bëhen rinumërimet eventuale", ka thënë Elezi.

Ai ka treguar se tani disa nga këto procese janë duke shkuar drejt fundit. "Disa nga aktivitetet që po zhvillohen në QNR pothuajse janë në fund, siç është skanimi i listës përfundimtare i votuesve si dhe futja e të dhënave nga formularët e rezultateve të kandidatëve dhe subjekteve politike. Po ashtu, shërbimi votues i KQZ-së është duke vijuar procesin e vlerësimit të rreth 43 500 pakove të supozuara me fletëvotime dhe selektimin e tyre, të cilat i kemi pranuar gjatë periudhës së votimit përmes postës. Ky proces verifikimi do të na

ndihmojë që të japim përgjigje se sa është numri i saktë i fletëvotimeve nga jashtë vendit", është shprehur Elezi. Sipas tij, deri më tani janë trajtuar një pjesë e këtyre pakove dhe pas procesit të vlerësimit janë aprovuar më shumë se 16 000 zarfe me fletëvotime, ndërsa janë refuzuar 6 800 të tjera. "Arsyet e refuzimit të tyre janë nga më të ndryshmet. Pjesa më e madhe e tyre, më shumë se 5 000, janë refuzuar për shkak se janë dërguar nga persona që nuk janë të regjistruar si votues jashtë Kosovës dhe për shkak se janë dërguar nga persona që janë refuzuar në periudhën e aplikimit. Arsyet e tjera se përse nuk janë aprovuar kanë të bëjnë me faktet se ato janë dërguar nga votues të



paidentifikuar (votim grupor), se në pakon që e kanë dërguar kanë bashkangjitur dokumente jovalide dhe se kanë dërguar fletëvotime më shumë se dy herë”, ka thënë Elezi.

Më tej, zëdhënësi i KQZ-së ka vlerësuar se shpallja e rezultatit përfundimtar nuk është duke u zvarritur. “Zgjedhjet e

Organizata “GERMIN”, përmes vëzhguesve të akredituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është duke vëzhguar procesin e verifikimit të pakove me fletëvotime nga jashtë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Nga kjo organizatë, përmes një njoftimi për media, është bërë me dije se deri të dielën në mesditë, 21 212

votues janë verifikuar, 6 401 votues të refuzuar dhe 14 811 të aprovuar. “GERMIN përmes vëzhguesve të akredituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është duke vëzhguar procesin e verifikimit të pakove me fletëvotime nga jashtë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Më poshtë gjeni informatat në lidhje me numrin e zarfeve

të verifikuara deri sot në mesditë, duke përfshirë ato të aprovuarat, të refuzuarat dhe arsyet e refuzimit të tyre. Në çdo ditë do t’ju mbajmë të informuar në lidhje me këtë proces deri në përfundimin e tij. Një pjesë e zarfeve të refuzuara do të rishqyrtohen edhe një herë nga KQZ-ja para se të fillojë procesi i numërimit”, është thënë në njoftimin e kësaj organizate.

Sot vendoset nëse do të ketë rinumërim të votave në disa vendvotime

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) sot (e hënë) do të vendosë nëse do të ketë rinumërim të votave në disa vendvotime të ndryshme, pasi aktualisht është duke u bërë auditimi i disa votave. Zëdhënësi i

KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë se pas marrjes së raportit, KQZ-ja do ta shqyrtojë atë dhe më pas do të vendoset në raport me rinumërimin. “Ka vendvotime që janë duke iu nënshtruar procesit të

auditimit dhe deri të hënën, më së largu, do të kemi raportin, ku QNR-ja do t’i paraqesë rekomandimet dhe më pas KQZ-ja vendos nëse do të ketë rinumërim në disa vendvotime”, ka thënë Elezi.

parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 2014 dhe 2017, kanë marrë pothuajse të njëjtën kohë për t’u përmbyllur. Nga dita e zgjedhjeve deri në certifikim të rezultateve, KQZ-së i janë dashur 27 ditë më 2014 dhe 28 ditë më 2017. Numri i vendvotimeve të rinumëruara ka qenë 21 për qind - 22 për qind e vendvotimeve”, ka thënë ai, duke treguar arsyet se pse zgjedhjet e vitit 2019 kanë marrë më shumë kohë. “Ndërsa zgjedhjet e vitit 2019,

nga dita e zgjedhjeve deri në certifikim janë përmbyllur brenda 53 ditëve. Në 2019-n procesi ka zgjatur më shumë për shkak të numrit të madh të vendvotimeve të rinumëruara, rreth 90 për qind e tyre apo 2 254 nga 2 547 vendvotime”, është shprehur zëdhënësi i KQZ-së.

Pas mbylljes së qendrave të votimit, ditën e zgjedhjeve, komisionarët në vendvotime numërojnë votat për subjektet politike dhe kandidatët për deputetë. Më pas, i tërë

materiali zgjedhor dërgohet në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR), ku verifikohen të dhënat e dërguara nga qendrat e votimit. Në rast se ka mospërputhje në rezultatet e formularëve me votat në kuti ose ka dyshime për parregullsi, atëherë materialet vendosen në karantinë dhe më pas nis procesi i verifikimit. Këto janë procedura që marrin kohë. Zyrtarët kanë konfirmuar se nga zgjedhjet e 14 shkurtit, në karantinë janë vendosur 101 kuti votimi.

Pas sqarimit të paqartësive eventuale, atëherë nis procesi i verifikimit dhe numërimit të votave me kusht dhe të atyre të ardhura me postë nga diaspora. Edhe ky proces merr disa ditë kohë. Sipas rezultatit preliminar të KQZ-së, në zgjedhjet e 14 shkurtit Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 47.85 për qind të votave, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës me 17.41 për qind, Lidhja Demokratike e Kosovës me 13.08 për qind të votave, ndërkaq Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka fituar 7.43 për qind të votave. Në këto zgjedhje kanë marrë pjesë shumë se 830 mijë qytetarë.

Refuzohen mbi 6 000 vota të diasporës

Klinaku: Lufta jonë ka qenë, është dhe do të mbetet e shenjtë

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Kryetari në detyrë i Organizatës së Veteranëve të Luftës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Faton Klinaku, ka thënë se publikimi i dosjeve të UNMIK-ut rreth vrasjeve të Xhemajl Mustafës dhe Ekrem Rexhës ka qëllime dashakeqëse. Ai ka shtuar se do të dështojë përpjekja e Gjykatës Speciale për njollosjen e luftës së UÇK-së. “Ripublikimi i dosjeve të dështuara të UNMIK-ut nga ana e mediumit të Baton Haxhiut është dashakeqës dhe me pasojë për opinionin publik. Ndërsa deklaratat e Milaim Zekës e të

disa eksponentëve të LDK-së, jo vetëm që kanë pasojë për publikun, por janë edhe një përpjekje e mjerë dhe për të ardhur keq për akuzim të padrejtë të udhëheqësve të UÇK-së, të cilët po përballen me ‘drejtësinë’ ndërkombëtare në Hagë. Ashtu siç kanë dështuar përpjekjet për njollosjen e luftës së lavdishme të UÇK-së nga ana e Serbisë, UNMIK-ut dhe EULEX-it, do të dështojnë edhe këto përpjekje të Gjykatës Speciale dhe ndihmësve të saj. Lufta jonë ka qenë, është dhe do të mbetet e shenjtë!”, ka shkruar Klinaku në llogarinë e vet në “Facebook”.



Shënohet 32-vjetori i grevës së minatorëve

MITROVICË, 21 SHKURT (ER) - Për shkak të gjendjes aktuale me pandeminë Covid-19, "Java e Minatorëve" është shënuar më ndryshe për dallim nga vitet paraprake, ku çdoherë është organizuar manifestim qendror për nder të grevës historike të minatorëve të "Trepçës" të vitit 1989. Me rastin e shënimit të përvjetorit të javës së minatorëve u organizuan disa aktivitete simbolike ku morën pjesë kryetari i komunës, Agim Bahtiri, bordi i ndërmarrjes "Trepça", së bashku me menaxhmentin, si dhe disa prej minatorëve.

Kryetari Bahtiri ka qenë i pranishëm në vizitën e realizuar te pllaka përkujtimore e punuar nga komuna në shenjë nderimi për të gjithë minatorët e vitit 1989, emrat e të cilëve janë të vendosur në atë pllakë. Në fjalën e tij, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka thënë se ishin minatorët që me grevën e tyre arritën t'i mobilizojnë gjithë shqiptarët kudo që janë, që të kyçen në aktivitetet mbarëkombëtare për çlirim nga okupatori serb, e kjo pa dyshim ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme në rrugëtimin tonë shekullor drejt lirisë dhe pavarësisë.



Mbahet gara 'Olimpiada e Matematikës' në Drenas



DRENAS, 21 SHKURT (ER) - Drejtoria e Arsimit në Drenas dhe Shoqata e Matematikanëve e Kosovës kanë mbajtur Olimpiadën Matematikë për klasat 9, 10, 11 dhe 12. Nga kjo garë do të caktohen përfaqësuesit e Komunës së Drenasit në Olimpiadën e XIII Matematikë të Kosovës e cila do të mbahet në

Gjimnazin e Specializuar Matematikor në Prishtinë më 27 shkurt. Nga Olimpiada Matematikë e Kosovës përzgjedhet ekipi prej gjashtë nxënësve që do ta përfaqësojnë shtetin e Kosovës në Olimpiadën e 62-të Matematikë Ndërkombëtare - IMO 2021, e cila do të mbahet në St. Petersburg, në Rusi, prej

datës 14. 7. 2021 deri më 24. 7. 2021, ku Kosova merr pjesë për herë të njëmbëdhjetë në cilësinë e anëtares me të drejta të plota. Këto gara kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë në arsim, për të cilën mbeten të përkushtuara Drejtoria e Arsimit dhe Komuna e Drenasit.

Zgjedhet kryetari dhe kryesia e Këshillit të Prindërve për Arsim në Podujevë

PODUJEVË, 21 SHKURT (ER) - Përfaqësuesit e Këshillave të Prindërve të shkollave të Komunës së Podujevës kanë mbajtur një takim në të cilin kanë zgjedhur kryesinë dhe kryetarin e Këshillit të Prindërve për Arsim të Komunës së Podujevës. Në këtë takim, ku ishte i pranishëm edhe nënkryetarja e komunës, Marigona Lahu dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu, Këshilli Komunal i Prindërve ka zgjedhur Nazif Sheqën kryetar i këtij Këshilli

dhe kryesinë prej nëntë anëtarësh. Po në këtë takim u diskutua edhe për çështje që kanë të bëjnë me investimet në infrastrukturën shkollore, për ngritjen e cilësisë në arsim si dhe për sigurinë e nxënësve në shkolla. Nënkryetarja e komunës, Marigona Lahu dhe drejtori i Arsimit, Avni Fetahu, u zotuan se Komuna e Podujevës do të punojë nëpër realizimin e obligimeve dhe nevojave të shkollave për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore.



Situata e sigurisë në Suharekë, stabile

SUHAREKË, 21 SHKURT (ER) - Anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Komunën e Suharekës kanë mbajtur takimin e radhës në të cilin kanë diskutuar për sigurinë në këtë komunë. Komandanti i Stacionit Policor në Suharekë, kapiten Afrim Sylaj, ka raportuar për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në këtë komunë, ku ka thënë se mes janarit 2020 dhe janarit 2021 ka rënie të rasteve të iniciuara për 14 për qind, si dhe në rastet e veprave penale

ka rënie prej 25-përqindësh. Ai ka thënë se në të gjitha rastet ka përmirësim të gjendjes. "Ka rënie të rasteve që shkaktojnë dukuri negative", është shprehur Sylaj. Për fillimin e procesit mësimor dhe çështjen e sigurisë nëpër shkolla ka raportuar drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, Remzi Bajselmani, i cili ka thënë se situata është stabile në shkolla, pasi nuk ka asnjë rast që është i infektuar me Covid-19.



Kosova, pa sovranitet ajror

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës menaxhohet nga Agjencia e Shërbimeve e Navigacionit Ajror të Kosovës, e cila ofron shërbime për aeroplanët civilë gjatë fluturimit në hapësirën ajrore të Kosovës me qëllim të aterimit dhe ngritjes nga Aeroporti i Prishtinës. Ndërsa hapësira e lartë ajrore nga 6,250 e më lart, e hapur për trafikun komercial nga viti 2014, është nën kontrollin e Hungarisë, përkatësisht të HungaroControl-it, i cili ofron shërbime teknike të kontrollit të trafikut në këtë lartësi



PRISHTINË, 21 SHKURT - Biletat e udhëtimit me aeroplan për dhe nga Kosova mund bëhen më të lira, kurse udhëtimet nga dhe në vendet perëndimore më të shkurtra, falë hapjes së korridoreve të reja të Kosovës me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Kosova, megjithatë, ende nuk arrin të kontrollojë të gjithë hapësirën ajrore dhe kjo është duke i kushtuar.

Për hapjen e korridoreve me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut ka njoftuar NATO-ja më 11 shkurt, ku është shtuar se kjo është një arritje e rëndësishme për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore mbi Kosovën.

Në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Marrëveshjen Teknike Ushtarake të vitit 1999, por edhe me ligjet e tanishme në Kosovë, komandanti i misionit të KFOR-it, përkatësisht NATO-s, është përgjegjës për sigurinë e hapësirës ajrore të Kosovës.

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës menaxhohet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës, e cila ofron shërbime për aeroplanët civilë

gjatë fluturimit në hapësirën ajrore të Kosovës me qëllim të aterimit dhe ngritjes nga Aeroporti i Prishtinës. Ndërsa hapësira e lartë ajrore nga 6 250 e më lart, e hapur për trafikun komercial nga viti 2014, është nën kontrollin e Hungarisë, përkatësisht të HungaroControl-it, i cili ofron shërbimet teknike të kontrollit të trafikut në këtë lartësi, për shkak se Kosova ende nuk ka arritur kapacitete për ta menaxhuar hapësirën e lartë ajrore.

Ndryshe, në hapësirën e ulët Kosova deri tash e ka shfrytëzuar vetëm korridorin me Maqedoninë e Veriut, thotë drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), Bahri Nuredini. "E rëndësishme së veçantë është se për avio-kompanitë të cilat [operojnë] dhe vijnë nga vendet perëndimore (me hapjen e korridoreve të reja) do të ketë nga 10 deri në 15 minuta fluturime më të shkurtra. Njëkohësisht do të ketë më pak emetim të karbonit dhe do të kemi një ambient më të pastër. Besojmë dhe vlerësojmë se kjo do të ndikojë edhe në uljen e kostos së vajtje-ardhjes së

biletave për qytetarët", ka theksuar Nuredini.

Sipas tij, autoritetet përkatëse vazhdojnë të angazhohen në mënyrë intensive që Kosova ta normalizojë plotësisht hapësirën e saj ajrore me vendet fqinje siç janë Mali i Zi dhe Serbia. "Ne shpresojmë që në vitin 2021 Kosova, si pjesë e Ballkanit Perëndimor, në aspektin e aviacionit civil, të ketë raporte të normalizuara", ka thënë Nuredini. Ai ka shtuar se komunikimet dhe bisedimet për normalizimin e raporteve në aspektin e aviacionit civil, i ndërmjetëson KFOR-i apo NATO-ja.

Korridori me Serbinë mbetet i mbyllur

Korridori me Serbinë është pezulluar që nga viti 1999, gjë që bën që fluturimet të jenë më të gjata, rrjedhimisht edhe më të shtrenjta, për dhe nga Kosova. Edhe pse ka pasur paralajmërime që në dialogun Kosovë - Serbi do të bisedohet për hapjen e këtij korridori, kjo nuk ka ndodhur.

Ali Aliu, njohës i çështjeve të aviacionit civil, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se

institucionet e Kosovës deri tash nuk janë marrë sa duhet me çështjet e aviacionit dhe menaxhimin e hapësirave ajrore. Sipas tij, çështja e normalizimit të hapësirës ajrore me vendet fqinje është dashur të përfundojë shumë kohë më parë. "Doemos është dashur që politika të luajë rolin e saj dhe me këmbëngulje të hyhet në biseda, me këmbëngulje të kërkohet ajo çfarë na takon si me Serbinë, po ashtu edhe me Malin e Zi. Mendoj se nuk është bërë sa duhet. Ndoshta këtu ka ndikuar mosnjohja e problematikës. Shkojnë bisedojnë atje dhe nuk e dinë për çka kanë shkuar", është shprehur Aliu.

Mekanizmat përkatës, thotë Aliu, kanë arritur të shkollojnë kuadro të reja dhe, siç shprehet ai, Kosova tashmë ka edhe infrastrukturën e duhur për menaxhimin e hapësirës ajrore. Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), Bahri Nuredini, ka pohuar se plani në të ardhmen është që Kosova të menaxhojë edhe hapësirën e lartë ajrore. Mosmenaxhimi i hapësirës së lartë aktualisht po i shkakton Kosovës humbje të

konsiderueshme. "Kosova çdo ditë që nuk e menaxhon hapësirën e vet ajrore ka humbje në aspektin financiar dhe e rëndësishme, mbi të gjitha, është se sovraniteti ajror ende nuk është nën autoritetet vendore. Po të menaxhohej hapësira ajrore, të hyrat do të ishin relativisht prej 5 deri në 8 milionë euro në vit, por gjithëherë në varshmëri prej avio-kompanive të cilat kanë shfrytëzuar lundrimin ajror në Republikën e Kosovës", ka deklaruar drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), Bahri Nuredini. Ai ka shtuar se bazuar në të dhënat që kjo agjenci ka e që janë publike, për vitin 2019 Hungaro-Control ka menaxhuar trafikun ajror prej 150 deri në 170 mijë fluturimesh, të cilat e kanë shfrytëzuar territorin e Kosovës si transit.

HungaroControl-i më 2014 kishte marrëveshje pesëvjeçare për kontroll të hapësirës së lartë ajrore të Kosovës dhe meqë Kosova ndërkohë nuk kishte arritur t'i plotësonte kriteret, në marrëveshje me NATO-n i është zgjatur marrëveshja për një afat të pacaktuar.

Buxheti i kufizuar për zotimet e Vetëvendosjes

PRISHTINË, 21 SHKURT - Buxheti i Kosovës prej 2.4 miliardë eurove paraqet vështirësi për realizimin e zotimeve të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) në aspektin ekonomik dhe social, thotë për Radion Evropa e Lirë, Arian Zeka, drejtor ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane të Kosovës.

Lëvizja Vetëvendosje ka fituar zgjedhjet e 14 shkurtit të mbajtura në Kosovë.

Megjithatë, sipas Zekës, nëse shteti arrin ta luftojë ekonominë joformale, e cila llogaritet të jetë deri 30 për qind e Bruto Produktit Vendor në Kosovë, atëherë arka e shtetit do të rritet dhe do të mundësohet realizimi i atyre zotimeve. “Në rrethana të tilla, kur ekonomia joformale është në një shkallë të lartë dhe buxheti i vendit është i kufizuar, është i vështirë zbatimi i zotimeve të LV-së, pa rritur edhe normat e tatimeve ekzistuese”, thotë Zeka.

Buxheti i Kosovës për vitin 2021 kap vlerën e 2.4 miliardë eurove dhe përgjatë viteve nuk ka pasur buxhet më të madh se ky i cili është në këtë vit.

Krijimi i Fondit Sovran, Banka Zhvillimore e Kosovës, punësimi deri në një vit të plotë

për të gjithë të rinjtë (mosha 16-18 vjeç), janë vetëm disa nga prioritetet në aspektin ekonomik në planprogramin e Lëvizjes Vetëvendosje.

LV-ja ka paraparë edhe anëtarësimin e Kosovës në Fondin Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë. Në mënyrë që të sigurohet një treg vendor që, sipas LV-së, nuk përbuz mundin e fermerëve, kjo parti do të sigurohet që të ketë çmime dysHEME për kulturat kryesore bujqësore e blegtorale. Në këtë fuqizim, LV-ja ka premtuar se do ta financojë bujqësinë për çdo vit deri në 100 milionë euro.

Futja e çmimeve referente për një sërë produktesh bazike bujqësore, midis tyre edhe për grurin dhe qumështin, është paraparë po ashtu në planprogramin e LV-së, me të cilin ka garuar për ta udhëhequr shtetin e Kosovës.

Ish-ministri i Ekonomisë dhe Financave në Kosovë, Haki Shatri, në një prononcim për “Radion Evropa e Lirë” thotë se partia fituese e zgjedhjeve të 14 shkurtit në planprogram nuk ka precizuar se në çfarë mandati do t'i bëjë ato zhvillime në ekonomi pasi, sipas tij, edhe në menaxhimin

më të mirë, vështirë se ato premtime mund të realizohen. Kosova, shton ai, ka të trashëguara probleme të mëdha ekonomike. “Buxheti prej 2.4 miliardë eurove nuk do të mjaftojë as t'i shërojë plagët e pandemisë që janë. Ka shumë vështirësi... papunësia, varfëria të gjitha problemet strukturore të ekonomisë. Nëse 10 për qind e zotimeve mund të realizohen në këtë vit dhe vitet në vazhdim, do të jetë sukses i mirë”, thotë Shatri.

LV-ja ka paraparë, po ashtu, rritje të skemave sociale. Aktualisht, baza e politikave sociale në Kosovë përbëhet nga skema të shumta sociale e pensionale. Në këto kategori hyjnë mbi 420 mijë qytetarëve të Kosovës dhe nga buxheti i shtetit çdo vit ndahen deri në 400 milionë euro.

Përveç skemave aktuale, LV-ja ka paraparë për të gjithë fëmijët nën moshën 2-vjeçare përfitime shtesa mujore në vlerë prej 20 eurove, kurse fëmijët nën moshën 16-vjeçare shuma që përfitojnë do të jetë 10 euro në muaj.

Ndërkaq, të gjitha familjet që kanë të ardhura të ulëta, do të rimbursohen varësisht prej të ardhurave vjetore që familja

merr. “Nga 50 euro për fëmijë, nëse familja ka të ardhura vjetore më pak se 7 mijë euro në vit, nga 100 euro për fëmijë nëse familja ka të ardhura vjetore më pak se 6 mijë euro, dhe nga 150 euro për secilin fëmijë nëse familja ka të ardhura vjetore më pak se 5 mijë euro”, thuhet në programin e LV-së. Lidhur me këto zotime, Zeka thotë se duhet treguar kujdes dhe gjithnjë duhet marrë në konsideratë kufizimet buxhetore që ka vendi. “Në të njëjtën kohë duhet marrë në konsideratë aftësinë e shtetit për mbledhjen e të hyrave, meqenëse nuk dëshirojmë të rrezikojmë stabilitetin buxhetor ose në ndonjë të ardhme të afërt të ballafaqohemi me rritjen e detyrimeve tatimore të bizneseve në rend të parë, meqenëse kjo do të bënte vendin më pak atraktiv për investime”, thotë Zeka.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, në raportin e fundit, ka vlerësuar se Kosova në vitin 2020 ka shënuar rënie të ekonomisë deri në 6 për qind. Ndërkaq, ka paraparë rritje ekonomike në vitin 2021 deri në 4.5 për qind. Ky mekanizëm

financiar ndërkombëtar, po ashtu, ka theksuar rëndësinë e kufizimit të rritjes së pagave në sektorin publik dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë së sistemit aktual të pensioneve përpara futjes së çdo ndryshimi.

LV-ja ka planifikuar që pagën minimale ta rrisë në 250 euro dhe se kjo pagë të përjashtohet nga tatimi në të ardhurat personale. Lidhur me këtë Zeka thotë se OEAK konsideron se paga minimale duhet të jetë rezultat i një aranzhimi mes punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe jo i ndërhyrjes së shtetit. “Nëse vetëm duhet të rritet paga minimale, duhet të merren në konsideratë kapacitetet e kompanive të sektorit privat. Ajo që qeveria duhet të bëjë përtej këtyre premtimeve është që të krijojë një mjedis të favorshëm që ndërmarrjet e sektorit privat të fuqizohen më tej”, thotë Zeka.

Adresimi i problemit të varfërisë dhe ulja e saj mbetet, po ashtu, kriter shumë i rëndësishëm i LV-së. Qeveria e Kosovës, thuhet në planprogramin e LV-së, nuk do të lejojë që 100 mijë qytetarë të jetojnë me më pak se 1 euro në ditë.



Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore shënoi rritje për 4.4 për qind

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2020 indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bimore ka shënuar rritje për 4.4 për qind, krahasuar me vitin 2019. Kurse indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 2.3 për qind në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi" 2015-2020 (2015=100). Për të bërë krahasime dhe për t'i vërejtur ndryshimet, janë prezantuar të dhënat për vitet 2015-2020 dhe për vitin bazik të vitit 2015 (2015=100).

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2020 indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për 4.4 për qind krahasuar me vitin 2019. Kurse indeksi i çmimeve të prodhimeve

blegtorale ka rritje për 2.3 për qind në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019. Indeksi total i çmimeve të prodhimeve bujqësore ka rritje për 3.2 për qind për vitin 2020. "Në vitin 2020 indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për 12.5 për qind krahasuar me vitin 2015. Indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 8.2 për qind në vitin 2020 krahasuar me vitin 2015. Indeksi vjetor total i prodhimeve bujqësore ka rritje për 10 për qind në vitin 2020 krahasuar me vitin 2015", është thënë në raportin e ASK-së.

Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore

vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vende të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen. Sipas ASK-së, prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe

blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Ndërkaq, në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër

kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në euro dhe njësitë matëse janë në kilogramë, litër dhe copë.

Pandemia, 54 për qind e shqiptarëve rritën blerjet në internet

Pandemia i dha zhvillim të pazakontë tregtisë online. Mbi 2 000 të rinj shqiptarë përfituan punë me pagesë nga shtëpia për kompani të huaja nëpërmjet platformave "Fiverr" dhe "Upwork", ndërsa 54 për qind e shqiptarëve rritën blerjet në internet

TIRANË, 21 SHKURT - Pandemia Covid-19 i dha hov të pazakontë ekonomisë digjitale në të gjithë botën, por edhe në Shqipëri, hapa të cilët do të duheshin të ndërmerreshin për dekada në periudhë normale. Pavarësisht prej mangësive dhe infrastrukturës të dobët, tregtia online, mësimi dhe puna në distancë, aftësitë mbi shërbimet digjitale u rritën me shpejtësi, duke hedhur bazat për një zhvillim të qëndrueshëm të e-commerce edhe në të ardhmen.

Mbi 2000 shqiptarë, kryesisht të rinj profesionistë, punuan me pagesë online për kompani të huaja. Banka Botërore, në një raport të posaçëm për zhvillimin e e-commerce gjatë pandemisë, vuri në dukje se Shqipëria pati një numër të lartë të profesionistëve që u regjistruan në platformat e punësimit online, "Fiverr", "Upwork" etj. Numri i

shqiptarëve të regjistruar në këto platforma shpesh kaloi atë të vendeve të zhvilluara, të cilët ofruan kryesisht shërbime për IT, arkitekt, përkthyes, menaxherë, këshillues, ekonomistë, inxhinierë IT etj. Të rinjtë shqiptarë profesionistë kanë marrë përgjithësisht vlerësime pozitive nga punëdhënësit, për shkak se ofrojnë shërbime të mira kundrejt një pagese jo shumë të lartë.

Ekonomistët e lartë të Bankës Botërore, Christoph Ungerer dhe Alberto Portugal, i pohan "Monitor"-it se pandemia nxiti ekonominë digjitale, porse qeveria dhe të gjitha grupet e interesit duhet të punojnë fort që të çojnë më tej këto zhvillime.

Studimi i tyre, që u bazua në një sondazh të nëntorit 2020 në vendet e Ballkanit Perëndimor, mbi mënyrën se si konsumatorët dhe bizneset e përdorën tregtinë elektronike gjatë kohës së



pandemisë, gjeti se Covid-19 ka përshpejtuar përdorimin e blerjeve në internet. 54 për qind e shqiptarëve të anketuar treguan se ata kanë rritur blerjet në internet gjatë krizës. Nga këta, 74 për qind besojnë se do të vazhdojnë të blejnë në internet më shpesh edhe kur

pandemia do të ketë kaluar. Tregjet online në Shqipëri karakterizohen nga shitjet e brendshme nëpërmjet rrjeteve sociale dhe dyqaneve lokale, përmes pagesave cash dhe blerjeve elektronike në platformat ndërkombëtare të tregtisë elektronike përmes

pagesave me karta elektronike. Nga të anketuarit shqiptarë që bëjnë blerje online, 67 për qind theksojnë se përdorin rrjetet sociale për të blerë nga dyqanet vendase, ndërsa 61 për qind deklarojnë se blejnë nga tregjet ndërkombëtare.

Zgjedhjet e 14 shkurtit, terapia më e duhur për t'i detektuar 'sëmundjet' e shtetit të Kosovës

Ajo që bie në sy, pa u thelluar shumë në analiza të hollësishme, është fakti se fitorja plebishitare e Albin Kurtit bashkë me Vjosa Osmanin në këto zgjedhje, përpos të tjerash, do të reflektojë edhe në proceset reformuese të partive të tjera, sidomos në PDK dhe LDK. Kjo edhe për faktin se që të dy, edhe Kurti edhe Osmani, ua morën disa adute elektorale bukur të forta PDK-së dhe LDK-së, duke i zëvendësuar ato me një diskurs të ri dhe krejtësisht të kapshëm për shumicën e votuesve



Nga Mehmet PRISHTINA

Java që po lëmë pas shënon jo vetëm numërimin e votave të fituara në zgjedhjet e 14 shkurtit, por edhe rënien ngritjet e entuziazmit politik, varësisht nga cili tabor vijon. Ajo që bie në sy, pa u thelluar shumë në analiza të hollësishme, është fakti se fitorja plebishitare e Albin Kurtit bashkë me Vjosa Osmanin në këto zgjedhje, përpos të tjerash, do të reflektojë edhe në proceset reformuese të partive të tjera, sidomos në PDK dhe LDK. Kjo

edhe për faktin se që të dy, edhe Kurti edhe Osmani, ua morën disa adute elektorale bukur të forta PDK-së dhe LDK-së, duke i zëvendësuar ato me një diskurs të ri dhe krejtësisht të kapshëm për shumicën e votuesve.

Nëse Albin Kurti arriti të sjellë një ofertë të re, që kryesisht përmbledhet në pak fjalë: drejtësi, zhvillim e punësim, kjo bëri që t'i joshë votuesit, të cilët për shumë vite ishin mësuar të dëgjojnë retorika mbi lavdinë e dikurshme të UÇK-së e cila u pat shndërruar në kauzë elektorale. Këto zgjedhje dëshmuar se edhe kauzat më të ndritshme mund të harxhohen, nëse ato nuk mbindërtohen me projekte e ide të reja që do t'iu hapnin njerëzve perspektivë. Këto zgjedhje dëshmuar se njerëzit janë lodhur me retorika pompoze që thirreshin në të kaluarën pa ofruar zgjidhje për

të ardhmen.

Në anën tjetër, Vjosa Osmani, arriti t'i bindë votuesit e lëkundur të LDK-së se flamuri i rugovizmit vazhdonte të qëndronte pikërisht në duart e saj, ndërkohë që garda e vjetër e kësaj partie me Rugovën "takohej" vetëm nëpër fushata zgjedhore. Zonja Osmani me elegancë arriti ta shpëtojë rugovizmin, i cili ishte zënë peng nga një mendësi e vjetër, duke e shndërruar këtë aksion politik në kauzë kryesore elektorale.

Gjatë kësaj periudhe, kur ende nuk ka përfunduar certifikimi i procesit zgjedhor, ka prirje aty-këtu që individë e subjekte të caktuara, humbjen elektorale ta shndërrojnë në njëfarë kontrabande postzgjedhore, për disa përfitime të vogla personale. Prirje të tilla ka pasur edhe në të kaluarën dhe kjo dëshmon se skena politike të Kosovës ende nuk është

pastruar nga mentaliteti i tuxharllëkut, prandaj në të ardhmen besimi ndaj institucioneve të shtetit nuk duhet të kërcënohet nga pazarxhinjtë e tillë që mallin e skaduar e paketojnë si ofertë gjoja të re.

Sido që të jetë, zgjedhjet e 14 shkurtit mund të shikohen në një prizëm mjaft afirmativ sa i përket kulturës politike të votuesve dhe të subjekteve politike, por edhe menaxhimit të përkryer të procesit zgjedhor nga ana e strukturave përgjegjëse që ishin të angazhuara për mbikëqyrjen e këtij procesi.

Kosova ditët e fundit po listohet në krye të lajmeve afirmative sa iu përket zgjedhjeve të 14 shkurtit. Madje nëpër disa studio televizive të Tiranës, Kosova po merret si model se si duhet të organizohen zgjedhjet, duke ia faturuar edhe klasës politike maturinë dhe pjekurinë për ta pranuar rezultatit zgjedhor, edhe atëherë kur ishte i disfavorshëm, vetëm pak orë pas përfundimit të zgjedhjeve. Do të donim që këto lajme afirmative t'iu kenë rënë në sy edhe zyrtarëve të lartë të BE-së, të cilët sigurisht do të duhej që në raportet e ardhshme t'i jepnin disa përparësi dhe nota

pozitive Kosovës në procesin euro-integrues, sidomos në disa çështje që lidhen me fazën para aderuese siç është, bie fjala, liberalizimi i vizave.

Evropa përfundimisht duhet ta shikojë Kosovën me dioptri reale, sepse vetëm në këtë mënyrë i ndihmon edhe klasës politike të përqendrohet në çështje që janë me prioritet, kurse qytetarët do të inkurajohen që të besojnë më tepër në rrugëtimin eurointegrues.

Nëse veprohet ndryshe, atëherë klasa politike nuk do të ketë kurrfarë motivi që të angazhohet për përmbushjen e agjendave reformuese, kurse qytetarët do të zhyten edhe më tej në ujërat e turbullt të euroskepticizmit.

Është një moment mjaft i qëlluar që Brukseli t'i trajtojë zgjedhjet e 14 shkurtit si terapinë më adekuate ndaj disa çështjeve të hapura që po e ngadalësojnë procesin euro-integrues të Kosovës, kurse klasa politike, në anën tjetër, sidomos ajo që do t'i drejtojë institucionet e shtetit në të ardhmen, të përqendrohet në vendosjen e shtetit në binarë normalë të funksionimit, duke filluar nga ekonomia e zhvillimi, e deri te siguria, arsimit dhe shëndetësia.



Ilire Vinca do të prezantohet me një ligjëratë në New York, pas nominimit në Ligën e Gruas Profesioniste të Teatrit në Amerikë

Aktorja dhe profesoresha universitare, Ilire Vinca, është nominuar për herë të dytë në Ligën e Gruas Profesioniste të Teatrit në Nju Jork.

Ajo së bashku me Zana Hoxhën dhe Burbuqe Berishën kanë arritur të hyjnë në listën prej 18 vende të botës.

Në programin e këtij viti, Vinca do të paraqitet nesër në një ligjëratë virtuale në Nju Jork të Amerikës, teksa do të prezantojë temën "Edukimi Teator: Arritja përtej skenës".

Për KultPlus, ajo ka rrëfyer emocionin e këtij çmimi të rëndësishëm, të cilën nuk e merr për të parën herë.

"Në kohën kur diplomacia ndërkombëtare është sfidë e vështirë për t'u kapërcyer, jemi krenarë për rolin që artistët luajnë si diplomatë kulturorë duke vendosur dialog krijues,

arsimor, jo politik", thotë për KultPlus Ilire Vinca.

Në anën tjetër, përvoja e saj e parë me këtë çmim ka qenë në vitin 2017.


"Ky është çmim që jepet çdo tre vjet, e për mua hera e parë ka qenë në vitin 2017 dhe tash për herë të dytë e rrita edhe pjesëmarrjen e Kosovës me Burbuqe Berishën dhe Zana Hoxhën", thotë artistja e famshme.

"Prej 26 vendeve të botës, 18 të nominuara, pjesëmarrja e Kosovës pas Anglisë radhitet e dyta", tregon Vinca.

Ilire Vinca është profesoreshë në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës.



Rreth 2500 gjuhë në botë drejt zhdukjes



Aktualisht ekzistojnë rreth 7 mijë gjuhë në botë dhe afërsisht 2500 prej tyre po përballen me rrezikun e zhdukjes, paralajmëroi një përfaqësues i Organizatës për Arsim, Shkencë dhe Kulturë të Kombeve të Bashkuara (UNESCO) në Turqi.

Duke folur për Anadolu Agency (AA) me rastin e 21 Shkurtit – Ditës

Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, kryetari i Komisionit Kombëtar të Turqisë (UTMK) të UNESCO-s, Prof. Dr. Alçal Oğuz, tha se nga 62 ditë ndërkombëtare të shpallura nga UNESCO, pesë kanë të bëjnë me gjuhët.

Oğuz thotë se në kuadër të kësaj dite, organizohen aktivitete për të mbrojtur diversitetin kulturor, si dhe për

të tërhequr vëmendjen ndaj diversitetit gjuhësor dhe gjuhëve që përballen me rrezikun e zhdukjes.

"Në botë ka rreth 7 mijë gjuhë. Në mesin e tyre, rreth 2.500 përballen me rrezikun e zhdukjes për shkak se numri i njerëzve që i flasin ato po zvogëlohet. Sipas statistikave dhe të dhënave të përpiluara, fatkeqësisht, në çdo 15 ditë,

një nga këto gjuhë zhduket", tha ai.

"Rrezikimi dhe zhdukja e gjuhëve është rritur viteve të fundit në veçanti për shkak të ndryshimeve sociale, politike dhe ekonomike në botë", shtoi Oğuz.

Sipas tij, shumica e gjuhëve të rrezikuara përbëhen nga gjuhë që fliten nga më pak se 10 mijë njerëz.

Ai po ashtu tha se është e vështirë të gjenden folës të rreth 200 gjuhëve.

"Numri i gjuhëve të zhdukura nga viti 1950 është mbi 250", tha Oğuz.

Shënimi më 21 shkurt i Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare është miratuar në Konferencën e Përgjithshme të 30-të të UNESCO-s më 17 nëntor të vitit 1999.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ballkani merr kryesimin në elitë, Llapi ia "terron" edhe Gjilanit

Ballkani dhe Llapi të dielën kanë marrë nga tri pikë shumë të rëndësishme në përballje me Feronikelin, përkatësisht Gjilanin. Fitore në këtë xhiro ka shënuar Trepça '89 ndaj Dritës, kurse Drenica ndau pikët me Besën



shkak të pozitës jashtëloje. Në minutën e 82-të, Krasniqi krosron për mrekulli deri te Mirlind Daku, i cili me kokë realizoi golin e fitores. Ballkani tash është lider me 44 pikë, kurse Feronikeli është në vendin e gjashtë me 24 pikë. Llapi ka shfaqur një lojë të madhe të dielën në përballje me Gjilanin, pasi ka mposhtur me rezultat 3-1. Llapi edhe në ndeshjen e parë të sezonit pranveror në Superligë arriti të marrë tri pikë ndaj një kundërshtari të fortë siç është Feronikeli (3-2). Vetëm tre minuta lojë iu deshën skuadrës së Llapit për të kaluar në epërsi 1-0, realizator i golit ishte Prençi. Pjesa e parë u mbyll me këtë rezultat, derisa dy minuta pasi filloi pjesa e dytë Mentor Zhdrella realizoi për 2-0. Pesë minuta më vonë, Progni e riktheu Gjilanin në lojë duke shënuar për 2-1. Në minutat

shtesë Llapi realizoi edhe golin e tretë dhe të fundit në këtë ndeshje për rezultatin 3-1. Llapi i Tahir Batatinës me tri pikët e reja ngritët në kuotën e 23 pikëve dhe zë vendin e shtatë në tabelë, kurse Gjilani është në pozitën e katërt me 30 pikë. Skuadra kampione në fuqi, Drita, është befasuar në shtëpi nga Trepça'89. Kjo e fundit ka arkëtuar pikët e plota nga ky udhëtim, duke iu gëzuar fitores me rezultat 2-1. Golat për skuadrën mitrovicase i shënuan Zeki Ademi në minutën e 14-t dhe Adenis Shala në minutat shtesë të pjesës së parë. Ndërkaq, golin e vetëm për kampionët e shënoi Kastriot

SUPERLIGA - Java 20

| | |
|-----------------------|-----|
| Llapi - Gjilani | 3-1 |
| Ballkani - Feronikeli | 1-0 |
| Drita - Trepça '89 | 1-2 |
| Drenica - Besa | 0-0 |
| Arbëria - Prishtina | 0-4 |

| Tabela | | Pikë |
|---------------|----|------|
| 1. Ballkani | 20 | 44 |
| 2. Drita | 20 | 44 |
| 3. Prishtina | 20 | 38 |
| 4. Gjilani | 20 | 30 |
| 5. Trepça '89 | 20 | 25 |
| 6. Feronikeli | 20 | 24 |
| 7. Llapi | 20 | 23 |
| 8. Arbëria | 20 | 22 |
| 9. Drenica | 20 | 20 |
| 10. Besa | 20 | 7 |

Në xhiron e radhës takohen: Gjilani-Ballkani, Trepça '89-Llapi, Feronikeli-Drenica, Besa-Arbëria, Prishtina-Drita.

Rexha, 10 minuta para fundit të ndeshjes. Në ndeshjen tjetër, Drenica nuk arriti të marrë më shumë se një pikë në duel me skuadrën e fundit në renditje, Besën. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin me bari sintetik në Drenas u mbyll pa gola. Pas këtij barazimi Drenica mbetet në pozitën e parafundit me 20 pikë.

Kualifikimi, mision i pamundur për Kosovën

PRISHTINË, 21 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll ka pësuar humbje nga Sllovakia 73:77 (23:15, 14:20, 17:20, 19:22) në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Kosova e motivuar e nisi ndeshjen më mirë, duke e fituar çerekun e parë 23:15. Për dallim nga ndeshja me Luksemburgu, "Dardanët" ishin shumë më të mirë në mbrojtje dhe me një lojë ekipore, e mbyllën çerekun e parë me tetë pikë epërsi, derisa me lojë të mirë vazhduan edhe në periudhën e dytë, ku kishin epërsi deri në 12 pikë, 32:20. Por, më pas sllovakët u treguan më të

mirë, duke ngushtuar shirat në 37:35, rezultat me të cilin përfundoi pjesa e parë. Perioda e tretë ishte shumë interesante dhe e luftuar nga dy skuadrat në parket. Epërsia më e lartë e vendasve ishte pesë pikë, kurse sllovakët arritën që të kalojnë në epërsi në një pikë dy herë, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 54:55. 10 minutat e fundit ishin mjaft të luftuar dhe përkundër përpjekjeve maksimale të "Dardanëve", Sllovakia fitoi 73:77. Kosova e përfundoi grupin me dy fitore dhe katër humbje, kurse sllovakët tri fitore dhe tri humbje, duke u kualifikuar tutje.



Interi fitoi derbin ndaj Milanit

Milano, 21 shkurt - Skuadra e Interit merr një fitore spektakolare në derbin ndaj Milanit, duke u konfirmuar si favorite për titullin kampion në Itali. Skuadra e Contes triumfoi 3-0 në "San Siro", një ndeshje të cilën e dominoi për pjesën më të madhe dhe ishte

më e saktë në konkretizimin e rasteve. Në minutën e 5-të, Lukaku shërben një top fantastik në zonë për Lautaro Martinez, i cili e kishte të thjeshtë të realizonte për 0-1. Milani futet me një ritëm më të mirë në fillimin e pjesës së dytë, por pa mundur që të

konkretizonte rastet. Në krahun tjetër, Interi realizon edhe të dytin në minutën e 57-të, duke përfunduar nga një kundërsulm që u shfrytëzua në mënyrën më të mirë nga Lautaro Martinez. Në minutën e 66-të, Lukaku merr një top thuajse nga mesfusha dhe më

pas arrin të bëjë shumë metra përpara derisa do të lëshonte një gjuajtje të fortë, e cila përfundoi në rjetën e kuqezinjve. Interi në këtë mënyrë merr një fitore shumë të rëndësishme, duke ruajtur vendin e parë me 53 pikë, plotë 4 më shumë se Milani.



Lala: Rashica do të largohet nga Bremeni

BREMEN, 21 SHKURT - Menaxheri i Milot Rashicës, Altin Lala, ka thënë se ylli i Kosovës pritet të largohet nga Werder Bremeni në fund të stinorit. "Për fat të keq ka

pasur dy lëndime, një në fillim të stinorit dhe një para se të përfundonte faza e parë dhe ai tashmë është rikthyer në formën më të mirë. Në lojën e fundit

ishte lojtari më i mirë. Shpresoj të vazhdojë me këto hapa. Unë mendoj se në fund të këtij stinori me shumë gjasë do të ndryshojë skuadër", ka thënë Lala për

"KosovaPress". Lala nuk ka dashur t'i përmendë emrat e skuadrave të interesuara për yllin e Përfaqësueses së Kosovës në futboll.



Marku, me 'knockout' teknik mposhti Charltonin

LONDËR, 21 SHKURT - Tjetër fitore në ring për Florian Markun. Boksieri shqiptar mposhti britanikun Rylan Charlton me "knockout" teknik në raundin e tetë, teksa stafi i anglezit hodhi peshqirin (shenjë e dorëzimit) në një moment të vështirë, kur Marku po i shkaktonte dëme të mëdha rivalit të tij. Dueli në arenën mitike të "Uembly"-t të Londrës ishte spektakolar, me grushtime të fuqishme nga të dy boksierët, madje anglezi Charlton e nisi më mirë, duke e vënë nën presion të vazhdueshëm Markun.

28-vjeçari shqiptar, i cili pësoi një "knockdown" në raundin e gjashtë, arriti ta fitonte terren dhe në fund, falë një serie grushtesh, e detyroi stafin e kundërshtarit të kërkonte dorëzimin. Florian Marku ka fituar shtatë takime dhe barazuar vetëm një në boksion profesionist në peshën "Welterweight", ku synon ta



arrijë majën. "Së pari falënderoj promotorin Eddie Hearn i cili më dha mundësinë të jem këtu e t'i realizoj ëndrrat e mia. Faleminderit shumë Eddie! Është e vërtetë që unë jam një kikkбоксер, por po tregoj se mund ta bëj shumë mirë edhe boksierin. Rylan ishte një boksier i vështirë. Urime edhe atij! Kjo është ëndrra ime. E dua këtë sport me gjithë shpirt. Nëse dikush më

mposht, unë e uroj atë. Kanë thënë që nuk di të boksoj, por e tregova veten time. Sot i jap vetes notën 7 për shkak të 'knockdown'-it. Kundërshtari kishte shumë fuqi. E uroj edhe një herë. Connor Ben nuk ka marrë kurrë të tilla risqe. Kam luftuar për 10 vjet rresht në Greqi më të mirë, ndërsa ai ndeshje me boksierë me tetë humbje. Ai është frikacak, nuk do të ndeshet me mua", ka deklaruar Marku.

Lakersat pësojnë humbjen e dytë radhazi

LOS ANXHELOS, 21 SHKURT - Los Angeles Lakersi ka pësuar edhe humbjen e dytë radhazi dhe të tretën në katër sfidat e fundit. Kampioni në fuqi i NBA-s është mposhtur në "Staples Center" nga nënkampioni Miami Heat me dy pikë diferencë 94-96. Ishte një ndeshje jashtëzakonisht interesante, ku krejt në fund është përcaktuar fituesi. Lakersat patën rastin ta fitojnë ndeshjen me aksionin e fundit, por Alex Caruso dështoi të shënonte për tri pikë. Kendrick Nunn ishte shënuesi më i mirë në këtë sfidë me 27 pikë, pesë kërcime e tri asistime. Me lojë të mirë u dallua edhe Jimmy Butler me 24 pikë e tetë kërcime te fituesit. Kyle Kuzma shënoi 23 pikë te Lakersat, ndërsa LeBron Jamesi e mbylli takimin me 19 pikë, nëntë kërcime e nëntë asistime, por që nuk mjaftuan për fitoren e Lakersave.



REZULTATET

Charlotte Hornets - Golden State Warriors
LA Lakers - Miami Heat

102-100
94-96

Ish-kapiteni i Realit: Në kohën time, italianët ta ndërlikonin jetën

Po afron ndeshja e Realit kundër Atalantës dhe në Spanjë kanë filluar të kujtojnë duelet e rëndësishme italo-spanjolle. Legjenda madriline Fernando Hierro ka folur në gazetën "AS"

duke thënë se këto duele kanë qenë vërtet spektakolare. "Në epokën time Italia kishte skuadra si Juventus, Interi dhe Milani. Në vitet '90 ata dominonin Evropën dhe ishin vitet e arta sportive për

ta. Ta ndërlikonin jetën me një mënyrë apo një tjetër. Unë i shijoj shumë ndeshjet me skuadrat italiane. Nuk do ta mohoj diçka të tillë, sepse motivohesha shumë. Flitej

shumë për italianet, për mentalitetin fitues, për përgatitjen fizike dhe taktikën. Ishin hapa përpara në këtë aspekt. Me Juventusin kemi pasur ndeshje të shkëlqyera dhe të forta

por, gjithashtu, edhe me Milanin. Ishin kampione të vërtetë. Reali duhet të luajë vetëm për fitore me Atalantën, edhe pse është ndeshje e vështirë", ka thënë Hierro.

SHKURT

City 'blindon' De Bruynen

Manchester City nuk do t'i dëgjojë ofertat për mesfushorin belg, Kevin de Bruyne, gjatë afatit kalimtar veror. Kështu ka raportuar gazetari i njohur italian Fabrizio Romano. Ai në profilin e tij zyrtar në "Twitter" bën me dije se De Bruyne është i paprekshëm te ekipi anglez. Gjithashtu, është shënuar përparim në bisedimet për zgjatjen e kontratës dhe marrëveshja do të arrihet së shpejti.

Gjokoviçi triumfon në Australian Open

Novak Gjokoviçi ka mposhtur Daniil Medvedev në finalen e Australian Open në tenis që u mbajt të dielën. Gjokoviçi tani ka nëntë finale, nëntë kampionate nën rripin e tij dhe vazhdon të fitojë ndaj Roger Federerit dhe Rafael Nadalit në renditjen e Grand Slamit, tani deri në 18 të përgjithshëm, dy larg rekordit të meshkujve të ndarë nga dy rivalët e tij, shkruan "Euronews". Gjokoviçi ka fituar gjashtë nga 10 turnet e fundit të mëdha dhe do të mbetet i pari në renditje të paktën deri më 8 mars. Kjo do t'i japë atij 311 javë në vendin e parë, duke thyer një rekord të mbajtur nga Federeri.

Pochettino e dëshiron Kanen në vend të Icardit

Mauricio Pochettino duket se ka ardhur me ide të qarta në krye të PSG-së. Trajneri argjentinas e ka bërë gati listën e dëshirave për merkaton e verës dhe në krye të saj ka vendosur emrin e Harry Kane. Pavarësisht se në ekip ka një sulmues si Icardi, duket se Pochettino nuk i beson Mauritos dhe kërkon që si "pykë" në formacionin e tij të jetë Harry Kane. Dyshja kanë punuar së bashku për shumë vite te Tottenhami dhe gëzojnë një marrëdhënie të shkëlqyer mes njëri-tjetrit. Sidoqoftë, i vështirë duke finalizimi i marrëveshjes me "Gjelat" e Londrës, pasi për të lënë të lirë një sulmues si Harry Kane, shtypi anglez bën me dije se presidenti i Tottenhamit kërkon të paktën 180 milionë euro. Gjithsesi, mbetet për t'u parë se çfarë do të ndodhë në merkaton e verës.

Britania e Madhe e gatshme t'i organizojë të gjitha ndeshjet e 'Euro 2020'

Britania e Madhe raportohet se është shprehur e gatshme për t'i organizuar të gjitha ndeshjet e Kampionatit Evropian 2020. "The Sunday Times" shkruan se qeveria britanike është duke hartuar planin për rikthimin e tifozëve në stadione në fund të majit. Olivier Dowden nga Ministria e Sportit i ka bërë të qartë UEFA-s se progresi në vaksinim do të thotë që tifozët të kthehen në stadione më herët sesa në shumicën e vendeve evropiane. Në "Wembley" të Londrës pritet të zhvillohet gjysmëfinalja dhe finalja, por burimet e gazetës angleze kanë thënë se nëse u kërkohej të presin më shumë ndeshje, nga Britania e Madhe do të jenë dakord. Kujtojmë se Kampionati Evropian 2020 kishte dështuar të mbahet në vitin e kaluar shkak i përhapjes së koronavirusit. "Euro 2020" do të zhvillohet në verën e këtij viti, teksa deri më tani zyrtarisht dihet se ndeshjet do të zhvillohen në 12 qytete evropiane: Shën Petersburg, Londër, Mynih, Romë, Bukuresht, Dublin, Kopenhagë, Bilbao, Glasgow, Budapest dhe Amsterdam.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti


ÇMIMI: 5.99 €



AGRON SHALA
DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Agro Invent" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 70457698 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Agro Invent" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr. 70457698, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Agro Invent" L.L.C. in Pristina, has come to the decision to quit its nr. 70457698, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Dragan Vukasinovic" I.B. Jazhincë, Shtërpcë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për akuakulturë – kultivimin e peshkut në Jazhincë komuna e Shtërpcës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.03.2021 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Hill" në Shtërpcë do të organizohet debat publik nga kompania "Dragan Vukasinovic" I.B. Jazhincë, Shtërpcë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për akuakulturë – kultivimin e peshkut në Jazhincë komuna e Shtërpcës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7640058539?pwd=UGk5N2RkalQ5aGRTRGx6VIRPNCtSUT09>

Meeting ID: 764 005 8539
Passcode: 2KEHjE

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Adonis Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën dhe katër dëftesat e shkollës së mesme "Abdyl Frashëri" Prishtinë.
- ▶ D.P.T "Sara" Shpalle te pavlefshme Certifikatën e biznesit me nrb: 70578808
- ▶ Muhamet Ibishi B.I shpalle te pavlefshme Certifikatën e Biznesit me Nrb 80117426
- ▶ Arbësa Smajli shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLM "Dr Xheladin Deda"
- ▶ Mihane Hyseni shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLM "Dr Xheladin Deda"
- ▶ Artan Kalludra shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"
- ▶ Arben Selimi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"
- ▶ Gresa Berisha B.I Shpalle te pavlefshme Certifikatën e biznesit me nrb: 810565228
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

